



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

**Shtojca 3- Raporti për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave në kuadër të
Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit¹**

Mars 2023

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 138-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 05/138 të datës 12.04.2023.

Tabela e përmbatjes

1. Hyrje	1
2. Baza ligjore dhe lista e lejimeve që administrohen nga MKRS	3
3. Të gjeturat kryesore dhe analiza ligjore	6
3.1. Parimi i ligjshmërisë	6
3.2. Pagesat dhe taksat	7
3.3. Aplikimi, shqyrtimi i lejimeve dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike	7
4. Rekomandimet	12
4.1. Rekomandime të përgjithshme	12
4.2. Rekomandimet e veçanta	13
Shtojca 1 – Rekomandimet e veçanta	14

Shkurtesat

KNF	Korporata Ndërkombëtare Financiare
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
KQVR	Këshilli Qëndror i Veprimit Rinor
Lejim	Njoftim, Regjistrim, Leje ose Licencë Profesionale
LSLL	Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
Regjistri	Regjistri i Lejeve dhe Licencave
U.A.	Udhëzim Administrativ

1. Hyrje

Projekti Klima e Investimeve II i Korporatës Ndërkombëtare Financiare (KNF)/pjesë e Grupit të Bankës Botërore, në kuadër të reformës për thjeshtësimin e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës në koordinim me Zyren Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, ka filluar analizën e inventarizimit dhe thjeshtësimin të lejimeve të administruara nga të gjitha ministritë duke përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (këtu e tutje “MKRS”). Reforma për thjeshtësimin e sistemit të lejimeve është një ndër faktorët kyç për krijimin e një kornize për promovimin e cilësisë rregulluese, brenda një konteksti më të gjerë të përmirësimit të qeverisjes, duke përfshirë transparencën, llogaridhëniën dhe efikasitetin e shërbimit ndaj qytetarëve duke krijuar një medis më të përshatshëm afarist.

Mandatimi i reformës së sistemit të lejimeve në Kosovë ka filluar me aprovimin e Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave në vitin 2013 (këtu e tutje “LSLL”) (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8967>). Ky ligj vendos parimet dhe rregullat kryesore për krijimin e lejeve dhe licencave të reja si dhe për lejet dhe licencat ekzistuese. LSLL përcakton që lejet dhe licencat do të krijohen vetëm në rastet e domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe përdorimit të resurseve natyrore në Republikën e Kosovës, duke parandaluar kështu krijimin e barrierave administrative për biznese në rastet tjera. LSLL gjithashtu kërkon shqyrtimin e të gjitha lejeve dhe licencave ekzistuese për të konstatuar përputhshmërinë me këto parime dhe rregulla. Në bazë të LSLL është krijuar edhe Regjistri i Lejeve dhe Licencave (këtu e tutje “Regjistri”) në të cilin janë identifikuar lejimet që administrohen nga të gjitha organet e administratës shtetërore (<http://lejelicenca.rks-gov.net/>). Në harmoni me kërkesat ligjore të LSLL, këtë vit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar një program për zvogëlimin e barrës administrative për të thjeshtësuar apo eliminuar procedurat dhe kërkesat që shkaktojnë shpenzime dhe humbje kohe për qytetarët e bizneset, që vlerësohen të panevojshme dhe që nuk mbrojnë interesin publik.

Sipas Shtojces 1, pikës 8.1. të Rregullores(QRK) - Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive², e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021³ dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2022⁴, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (këtu e tuje “MKRS”) është përgjegjëse për “[p]ërgatitjen e politikave publike,

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=47884>

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=60962>

hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e kulturës, rinisë, sportit, të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.” Në kuadrin e përgjegjësive të saj, MKRS ndër të tjera administron një sërë lejimesh për aktivitete të ndryshme duke përfshirë licencimin e federatave sportive, dhënien e lejes për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta, dhënien e licencës për veprimtaritë botuese, njohjen/regjistrimin e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor, dhënien e licencës profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe licencës profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ky raport ka për qëllim studimin dhe analizën e kornizës ligjore për lejimet e administruara dhe implemetimin e kësaj kornize në praktikë si dhe dhënien e rekomandimeve për thjeshtësimin e këtyre lejimeve në kuadër të MKRS-së.

Hartimi i këtij raporti është zhvilluar në 3 faza, si vijon:

Faza e Parë: Analiza preliminare ligjore e lejimeve që administrohen nga MKRS.

Faza e Dytë: Zhvillimi i takimeve me përfaqesues nga departamentet përkaëse të MKRS-së për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e formularëve me informata të detajuara për secilin lejim.

Faza e Tretë: Shqyrtimi përfundimtar i informacionit të mbledhur dhe hartimi i raportit.

Gjatë fazës së parë, është bërë një analizë preliminare e legjislacionit relevant duke përfshirë ligjet për Sportin, të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Veprimtarinë Botuese, Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë dhe Trashëgiminë Kulturore, të gjitha Udhëzimet Administrative (këtu e tutje “U.A.”) që rrjedhin nga këto akte ligjore, si dhe është analizuar përmbajtja e Regjstrit për lejimet.

Gjatë fazës së dytë janë zhvilluar takime dhe konsultime me përfaqesues nga departamenti ligjor, departamenti i sportit, zyra për të drejtat e autorit, departamenti i kulturës, departamenti i rinisë, dhe departamenti për trashëgimi kulturore të MKRS-së për mbledhjen e të dhënave dhe plotësimin e formularëve me informata të detajuara për secilin lejim.

Gjatë fazës së tretë janë verifikuar dhe analizuar të gjitha informatat e mbledhura me anë të formularëve kundrejt dispozitave ligjore përkatëse për secilin lejim. Më tutje janë identifikuar

mundësitë për thjeshtësim të këtyre lejimeve që ka rezultuar me paraqitjen e tyre në formë të rekomandimeve për ndryshime dhe plotësime ligjore në këtë raport.

Struktura e raportit është organizuar në këtë mënyrë: në Kapitullin 2 të këtij raporti, është paraqitur kuadri kryesor ligjor që rregullon lejimet që administrohen nga MKRS, nërsa kapitulli 3 i dedikohet analizës së legjislacionit kryesor që rregullon lejimet në Kosovë në përgjiithësi dhe vendos parimet bazë të cilat janë të zbatueshme për lejimet që administrohen nga MKRS në veçanti. Në këtë kapitull vëmendje e veçantë u kushtohet LSSL dhe LPPA që në mënyrë horizontale përcaktojnë parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes si dhe realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Në fund në Kapitullin 4, në bazë të analizës dhe gjetjeve sipas Kapitullit 2 dhe 3, janë paraqitur rekomandimet e përgjithshme, dhe ato veçanta të cilat janë shtjelluar në mënyrë të detajuar në Shtojcën 1 të këtij raporti.

2. Baza ligjore dhe lista e lejimeve që administrohen nga MKRS

Sic është theksuar më lartë, dhënia dhe administrimi i lejimeve në kuadër të MKRS-së përcaktohen me anë të një sërë ligjesh, duke përfshirë Ligjin Nr. 2004/24 të Sportit (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2490>) (këtu e tutje “Ligji i Sportit”), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/I-075 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2802>) dhe Ligjin Nr. 06/I-115 (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18916>), Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2787>) (këtu e tutje “Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta”), Ligjit Nr. 02/L-51 për Veprimtarinë Botuese dhe Librin (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2432>) (këtu e tuje “Ligji për për Veprimtarinë Botuese dhe Librin), Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2654>) (këtu e tutje “Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë”) dhe Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2533>) (këtu e tutje “Ligji për Trashëgiminë Kulturore”).

Aspekte të ndryshme të zbatimit të lejimeve përcaktohen në një numër të akteve nënligjore. Për licencimin e federatave sportive çështjet si procedura e aplikimit dhe dhënia e licencës, dokumentacioni i kërkuar, procedura e ankesës etj., përcaktohen me anë të Udhëzimit Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59343>). Për Lejen për administrim kolektiv të të drejtave të autorit

dhe të drejtave të përbashkëta, çështjet si procedurat e dhënies, përkatesisht marrjes së lejes, afatet, kërkesat e dokumentacionit etj., rregullohen me Rregulloren Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatesisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8379>). Poashtu sa i përket licencës për veprimtaritë botuese me Rregulloren Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8379>) përcaktohen kushtet për dhënien e licencës, afatet, dokumentacioni i këkuar etj. Për Këshillin Qëndror të Veprimit Rinor, Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7899>) përcakton procedurat e njohjes, afatet etj. Ndërsa Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për personat fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=51792>) rregullon procedurën e aplikimit dhe vendim-marrjes, ankesës si dhe përcakton tarifën përkatëse për licencën profesionale për persona fizikë për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe licencën profesionale për persona juridikë për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në bazë të nenit 5 të LSSL përcaktohen 4 kategori të Lejimeve në 1) njoftim, 2) regjistrim, 3) leje, dhe 4) licencë profesionale “të listuara në renditje proporcionale me nivelin e rrezikut të cilin secili lloj është i projektuar të adresojë, nga rreziku më i ultë për shëndetin publik, sigurinë publike ose mjedisin ose ndikimin më të ultë në përdorimin e resurseve natyrore deri te rreziku apo ndikimi më i lartë.” Nga analiza e akteve ligjore dhe nënligjore të cekura më lartë rezultojnë që MKRS administron 6 lejime, 5 nga keto hyjnë në kategorinë e licencave dhe lejeve dhe 1 në kategorinë e regjistrimeve. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat bazike për secilin lejim të administruar nga MKRS.

Tabela Nr.1. Lejimet e administruara nga MKRS

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit			
Nr.	Emërtimi	Lloji i lejitimit (sipas LSSL)	Aktet Juridike
MKRS-1	Licencimi i federatave sportive	Licencë	Ligji Nr. 2004/24 të Sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/I-075 dhe Ligjin Nr. 06/I-115

			Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive
MKRS-2	Leje për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta	Licencë	Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta Rregullore Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatësisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta
MKRS-3	Licencë për veprimtarinë botuese	Licencë	Ligji Nr. 02/L-51 për Veprimtarinë Botuese dhe Librin Rregullore Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë
MKRS-4	Vendim për njohjen e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor	Regjistrim	Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë
MKRS-5	Licencë profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore	Licencë	Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për personat fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore

MKRS-6	Licencë profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore	Licencë	Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për personat fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore
--------	--	---------	---

3. Të gjeturat kryesore dhe analiza ligjore

Kjo pjesë e raportit i dedikohet analizës së legjislacionit kryesor që rregullon lejimet në Kosovë në përgjithësi dhe vendos parimet bazë të cilat janë të zbatueshme për lejimet që administrohen nga MKRS në veçanti. LSLI është ligj i përgjithshëm me efekt horizontal që përcakton parimet dhe rregullat për përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative si dhe të zhvillimit të veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës⁵. Ligj tjetër i përgjithshëm me efekt horizontal për të gjitha lejimet që rregullon në përgjithësi ushtrimin e autoritetit publik nga organet shtetore qendrore dhe lokale është Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tuje “LPPA”), qëllimi i të cilit është që të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave.⁶ Më poshtë do të analizohen disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parashikuara në këto ligje dhe ndërlidhshmëria e tyre me rregullat e veçanta egzistuese në legjislacionin që rregullon lejimet e administruara nga MKRS.

3.1. Parimi i ligjshmërisë

⁵ Neni 1, Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

⁶ Neni 1, Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Parimi i ligjshmërisë, në rastin konkret, ka të bëjë me domosdoshmërinë e të qenit në përputhje me ligjin të një akti tjetër ligjor. Ky parim përcaktohet si kërkesë dhe obligim ligjor në LSSL, LPPA, si dhe në Kushtetutën e Kosovës. Nga interpretimi i këtyre dispozitave e posaçërisht nenit 17 të LSSL, përcaktimi i lejeve dhe licencave duhet të parashihet vetëm me ligj. Baza ligjore për lejimet e administruara nga MKRS është e përcaktuar dhe e qartë për 5 nga lejimet, por jo edhe për vendimin për njohjen e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor (këtu e tutje “KQVR”). Më saktësisht, neni 8 i Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë vetëm e përshkruan se KQVR është organizim vullnetar i organizatave rinore që veprojnë në Kosovë dhe formacion këshillues për çështje rinore, që përfaqëson interesat e organizatave rinore tek institucionet e pushtetit qendror dhe te mekanizmat rinorë ndërkombëtarë. Ndërsa Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë e përcakton procedurën e regjistrimit dhe vendimin për njohje të KQVR bashkë me kriteret tjera, edhe pse mungon një bazë e qartë ligjore në Ligj për këtë lejim. Ky rregullim nuk është në pajtueshmeri me nenin 17 të LSSL i cili parasheh që lejimet mund të përcaktohen vetëm me anë të ligjit.

3.2. Pagesat dhe taksat

Nga 6 lejimet e administruara nga MKRS, tarifata zbatohen vetëm për Licencën profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe Licencën profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore. Nga analiza e këtyre tarifave vërehet se vendosja e tyre është bërë pa ndonjë kriter të qartë që është në kundërshtim me parimin e vendosjes së tarifës në bazë të shpenzimit të procedurës së organit publik. Siç është cekur më lartë, ky kriter është i përcaktuar në nenin 18 të LSSL, paragrafin 2 të nenit 12 të LPPA. Rrjedhimisht, është i nevojshëm rishikimi i këtyre tarifave dhe nëse nuk janë caktuar sipas këtij parimi, të zëvendësohen me nivelet e tarifave të llogaritura në bazë të këtij parimi.

3.3. Aplikimi, shqyrtimi i lejimeve dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike

Aplikimi dhe zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike është një tjetër aspekt i cili ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat e personave për t'u pajisur me një leje apo licencë, apo për të bërë

regjistrimin e KQRV-së. Aplikimi elektronik është kërkesë ligjore e LSSL, ndërsa zhvillimi i procedurës në mënyrë elektronike kërkesë e LPPA. Në rastin konkret MKRS nuk ka një sistem elektronik për qëllim të aplikimit dhe zhvillimit të procedurës së shqyrtimit për lejimet e administruara. Kjo çështje pritet të adresohet me anë të programit qeveritar për zvogëlimin e barrës administrative.

Sa i përket licencimit të federatave sportive egzistojnë kundërthënie në mes të dispozitave të Ligjit të Sportit. Përkatësisht neni 31 paragrafi 2 këtë lejm e emërton si leje ndërsa në nenin 32 paragrafi 1 i referohet si federatë e licencuar. Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive përkates, këtij lejimi i referohet si Licencë. Në nenin 24 paragrafi 6 I U.A. përcaktohet se para vendim-marrjes përfundimtare nga ana e ministrit, Komisioni publikon raportin me rekomandime për dhënien ose jo të licencës dhe në afat prej 15 ditësh palët e pakënaqura mund të parashtrojnë ankesë në organin kompetent të shkallës së dytë. Neni 27 paragrafi 3 I U.A. parasheh që afati përfundimtar për vendimin lidhur me licencimin apo refuzimin e licencës është 60 ditë. Kjo shërben si bazë për thjeshtësim të këtij lejimi, pra harmonizimin, përkatësisht zvogëlimin e këtij afati sipas neni 98 të LPPA. Në lidhje me ankesën, ligji i Sportit nuk parasheh procedurë të ankesës, ndërsa neni 30 i U.A. parasheh themelimin e komisionit të ankesave dhe zhvillimin e procedurës sipas dispozitave të LPPA. Tutje, U.A. përmban një shtojcë për aplikim në të cilën nuk përcaktohet qartë në disa prej kërkesave për dokumentacion nëse kërkohet dokument origjinal apo vetëm kopje. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim përcaktohet në Neni 12 të U.A. ku në mes tjerash, kërkohen certifikata apo kopje të noterizuara për dokumentet që leshohen nga organet tjera shtetërore. Këtu përfshihen certifikata apo kopja e noterizuar e regjistrimit në Departamentin përkatës për OJQ-të, certifikata apo kopja e noterizuar e numrit fiskal. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim për t'u mundësuar palëve vetëm dorëzimin e kopjeve të këtyre dokumenteve që do të rezultonte me zvogëlimin e barrës administrative për palët. Licencimi i federatave që aplikojnë për herë të parë, që i kanë plotësuar kriteret për licencim, bëhet me kohëzgjatje njëvjeçare. Sipas U.A. neni 18 paragrafi 5, gjatë periudhës njëvjeçare, federata e licencuar është e obliguar që të dëshmojë përmbushjen e kriterëve për të aplikuar për ri-vlerësimin e licencës Licencimi pas ri-vlerësimit, zgjatë më së shumti 4 vjet dhe kjo kohëzgjatje e afatit të licencave është e lidhur me ciklin olimpik. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim, përkatësisht të mundësohet dhënia e licencës pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në LSSL. Poashtu, sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimi si licencim nuk është adekuat.

Në lidhje me Lejen për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta, baza ligjore që shërben për këtë lejm është Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përaferta, përkatësisht neni 161 paragrafi 1 dhe neni 172 dhe nuk ka afat të

vlefshmërisë. Sipas Nenit 172 paragrafi 2 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përaferta, kundër vendimit për mosdhënien e lejes, shoqata nuk ka të drejtë ankese, mirëpo në gjykatën kompetente mund të ngritët padi sipas dispozitave të procedurës administrative. Sipas Rregullores Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatësisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta, neni 4, afati për nxjerrjen e vendimit për kërkesen për leje është 3 muaj. Kjo shërben si bazë për thjeshtësim të këtij lejimi, pra harmonizimin, përkatësisht zvogëlimin e këtij afati sipas nenit 98 të LPPA. Sipas Rregullores, neni 21 për kërkesat e dokumentacionit, në mes tjerash kerkohen edhe kontratë qiraje dhe certifikatë e OJQ-së. Këtu poashtu ka hapësirë për thjeshtësim për t'u mundësuar palëve vetëm dorëzimin e kopjeve të këtyre dokumenteve që do të rezultonte me zvogëlimin e barrës administrative për palët.

Sa i përket Licencës për veprimtaritë botuese, bazë ligjore për këtë licencë shërben Ligji për veprimtari botuese, neni 16 paragrafi 19.2. Sipas Rregullores Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë, neni 7 paragrafi 4, afati për shqyrtimin e kërkesës për këtë licencë është 60 ditë. Kjo shërben si bazë për thjeshtësim të këtij lejimi, pra harmonizimin, përkatësisht zvogëlimin e këtij afati sipas nenit 98 të LPPA. Sipas Rregullores, neni 7 paragrafi 5 dhe 6, ankesa kundër vendimit i drejtohet Ministrit i cili brenda 30 ditëve merr vendim, që është në pajtueshmëri me LPPA. Tutje sipas Rregullores, neni 19 në dokumentacionin e kërkuar, në mes tjerash kërkohet edhe certifikata e regjistrimit si biznes. Këtu poashtu ka hapësirë për thjeshtësim për t'u mundësuar palëve vetëm dorëzimin e kopjeve të këtyre dokumenteve që do të rezultonte me zvogëlimin e barrës administrative për palët. Vlen të theksohet se kjo licencë nuk është zbatuar asnjë herë deri më sot. Sipas U.A. neni 9, afati i vleshshmërisë së kësaj licence është 5 vite. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim, përkatësisht të mundësohet dhënia e licencës pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në nenin 22 të LSSL. Poashtu, sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimi si licencë nuk është adekuat. Kjo licencë nuk është përfshirë në Regjistrin Qëndror të Lejeve dhe Licencave dhe rekomandohet përfshirja e saj.

Për Vendimin për njohjen e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor (KQVR) Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, neni 8, vetëm qartëson cka nënkupton KQVR, por nuk e përcakton si lejim. Si rrjedhojë, nuk ka bazë të qartë ligjore në Ligj për KQVR si lejim, përkatësisht regjistrim. Prandaj është i nevojshëm plotësimi i këtij Ligji për të përcaktuar qartë bazën ligjore për këtë lejim, në linjë me LSSL. Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave të veprimit rinor në Kosovë, neni 1 këtij lejimi i referohet si regjistrim. Në nenin 6 të Rregullores përcaktohen procedurat për njohjen e KQVR-së nga MKRS sipas shtojces 1 të Ligjit, pas regjistrimit në bazë të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare. Ministri lëshon vendimin e njohjes brenda 30 ditëve pas paraqitjes së kërkesës, sipas nenit 6 paragrafi 3 i Rregullores. Ky afat është në pajtueshmëri me LPPA. Sipas Rregullores,

neni 7 ankesa në vendim mund të bëhet sipas legjislacionit në fuqi. Detaje tjera nuk përcaktohen në Rregullore, duke nenkuptuar kështu se procedura zhvillohet në bazë të dispozitave të LPPA për ankesën. Vlefshmëria e vendimit nuk ka afat. Ky lejim nuk është përfshirë në Regjistrin Qëndror të Lejeve dhe Licencave dhe rekomandohet përfshirja e tij.

Sa i përket Licencës profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore bazë ligjore për këtë licencë është Ligji për Trashëgiminë Kulturore, neni 4, paragrafi 4.16, neni 7, paragrafi 7.21, neni 9, paragrafi 9.13 dhe 9.26 dhe Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik në fushën e trashëgimisë kulturore, neni 14. Sipas këtij U.A.neni 5 paragrafi 2 Licenca profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore, përfshin këto 5 kategori:

1. Licencë A1 për hartim të projekteve për konservim / restaurim dhe mbikëqyrje të implementimit në fushën e trashëgimisë kulturore të paluajtshme;
2. Licencë A2 për zbatim të punëve të konservimit / restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme;
3. Licencë A3 për hartim dhe zbatim të projekteve të konservimit / restaurimit të trashëgimisë kulturore të luajtshme;
4. Licencë A4 për gërmime arkeologjike;
5. Licencë A5 për specializime të veçanta.

Aplikacioni dhe dokumentacioni pranohet dhe procedohet nga Departamenti i Kultures. Me pas lenda verifikohet dhe shqyrtohet nga Komisioni për Licencim. Licenca lëshohet me vendim të Ministrit. Pala e interesuar aplikon për njëren nga 5 kategoritë (apo nënkategoritë) e kësaj licence duke e paraqitur kërkesën si dhe dokumentacionin për licencim tek Sekretari i Bordit të Licencimit (Departamenti i Trashëgimisë Kulturore), i cili edhe bën procedimin e dokumentacionit. Më pas lenda shqyrtohet nga Bordi i Licencimit në përbërje prej 5 anëtarësh i cili merr vendimin për kërkesën për licencë. Licenca lëshohet e nënshkruar nga Ministri dhe vlen për afat kohor 5 vjeçar, pas skadimit të të cilit pala duhet të aplikojë për rilicencim. Procedura për perterirje të licencës është e njëjtë. U.A. nuk përcakton ndonjë afat për shqyrtimin e kërkesës por në nenin 28 paragrafi 2 i referohet LPPA, që nënkupton se afati për shqyrtimin e kërkesës është 45 ditë. Sipas U.A., neni 37, e drejta për ankesë ndaj një vendimi administrativ bëhet siç është përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave që nënkupton se çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e ankesës në Ministri brenda 30 ditëve nga data e publikimit të vendimit për refuzim të licencës profesionale pranë komisionit për ankesa, i cili formohet me vendim nga ministri. Procedurat e punës së komisionit të ankesave zbatohen në përputhje me Ligjin nr. 05/L – 031 për Procedurën Administrative. Komisioni i ankesave përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, prej të

cilëve 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, një nga Departamenti Ligjor dhe një profesionist i fushës i përcaktuar nga ministra. Sipas U.A. neni 32, për këtë procedure, zbatohen tarifat si ne vijim:

1. Licenca A1 dhe A4 - 100 euro,
2. Licenca A2 dhe A3 - 70 euro,
3. Licenca A5 - 70 ose 100 euro, varesisht nga nënkategoria,

Per rilicencim paguhet 50 % e tarifës fillestare. Rrjedhimisht, është i nevojshëm rishikimi këtyre tarifave dhe nëse nuk janë caktuar sipas parimit të shpenzimit të procedurës sërganit kompetent të zëvendësohen me nivelet e tarifave të llogaritura në bazë të këtij parimi. Sipas U.A. neni 18 paragrafi 1, afati i vleshshmërisë së kësaj licence është 5 vite. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim, përkatësisht të mundësohet dhënia e licencës pa afat përderisa verifikimi i plotësisht të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në LSSL. Kjo licencë nuk është përfshirë në Regjistrin Qëndror të Lejeve dhe Licencave dhe rekomandohet përfshirja e saj.

Më në fund, për Licencën profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore baza ligjore për këtë licencë është Ligji për Trashëgiminë Kulturore, neni 4, paragrafi 4.16, neni 7, paragrafi 7.21, neni 9, paragrafi 9.13 dhe 9.26 dhe Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik në fushën e trashëgimisë kulturore, neni 15. U.A. nuk përcakton ndonjë afat për shqyrtimin e kërkesës por në nenin 28 paragrafi 2 i referohet LPPA, që nënkupton se afati për shqyrtimin e kërkesës është 45 ditë. Sipas U.A., neni 37, e drejta për ankesë ndaj një vendimi administrativ bëhet siç është përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave., që nënkupton se çdo person fizik dhe juridik ka të drejtën e ankesës në Ministri brenda 30 ditëve nga data e publikimit të vendimit për refuzim të licencës profesionale pranë komisionit për ankesa, i cili formohet me vendim nga ministri. Procedurat e punës së komisionit të ankesave zbatohen në përputhje me Ligjin nr. 05/L – 031 për Procedurën Administrative. Komisioni i ankesave përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, prej të cilëve 1 (një) përfaqësues nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, një nga Departamenti Ligjor dhe një profesionist i fushës i përcaktuar nga ministra.

Sipas U.A, neni 32, për këtë procedurë, zbatohen tarifat si në vijim:

1. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B1 - 500 euro;
2. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B2 - 700 euro;
3. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B3 – 1,000 euro;
4. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B4 – 1,000 euro;

5. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B5 – 3,000 euro;

Për rilicencimin e personave juridikë paguhet 50% e shumës së përcaktuar në këtë U.A. Rrjedhimisht, është i nevojshëm rishikimi këtyre tarifave dhe nëse nuk janë caktuar sipas parimit të shpenzimit të procedurës së organit kompetent të zëvendësohen me nivelet e tarifave të llogaritura në bazë të këtij parimi. Sipas U.A. neni 15, Dokumentacioni i kërkuar për këtë aplikim, në mes tjerash përfshinë kopjet e noterizuara të licencave të stafit profesional në bazë të të cilit personi juridik kërkon të licencohet, kopjet e noterizuara të kontratave të punës me afat të pacaktuar ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe stafit profesional të licencuar në bazë të të cilit kërkon të licencohet, certifikatën e regjistrimit si person juridik pranë institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës, dhe certifikatën e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Këtu poashtu ka hapësirë për thjeshtësim për t'u mundësuar palëve vetëm dorëzimin e kopjeve të këtyre dokumenteve që do të rezultonte me zvogëlimin e barrës administrative për palët. Sipas U.A. neni 18 paragrafi 2, afati i vleshfshmërisë së kësaj licence është 5 vite. Këtu ka hapësirë për thjeshtësim, përkatësisht të mundësohet dhënia e licencës pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në LSSL. Poashtu, për shkak se me LSSL licencimi behet vetem per personat fizik dhe jo per personat juridik, atehere eshte i nevojshem harmonizimi i U.A. me LSSL , Ky lejim nuk është përfshirë në Regjistrin Qëndror të Lejeve dhe Licencave dhe rekomandohet përfshirja e tij.

4. Rekomandimet

Rekomandimet e dala nga ky raport do të fokusohen në nevojën e harmonizimit të legjislacionit të tanishëm me LSSL dhe LPPA si ligje të cilat kanë efekt horizontal duke përcaktuar në menyrë të qartë me anë të Ligjit të lejimeve të administruara nga MKRS, vendosjen e tarifave në bazë të parimit të shpenzimit të procedurës për shqyrtimin e aplikimeve për lejime nga organi kompetent, si dhe lehtësime tjera të barrës administrative për palën që kanë të bëjnë me eliminimin e kërkesave të panevojshme për dokumentacion dhe reduktimin e afateve të paarsyeshme dhe jo të bazuara në LPPA. Në vijim janë paraqitur rekomandimet e përgjithshme, dhe ato të vecanta të cilat janë shtjelluar në mënyrë të detajuar në Shtojcën 1 të këtij raporti.

4.1. Rekomandime të përgjithshme

Sipas analizës së lejimeve të administruara nga MKRS janë identifikuar të gjeturat kryesore në bazë të të cilave janë nxjerrë rekomandimet e përgjithshme si në vijim:

- Lejet dhe licencat të jepen pa afat përderisa verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore mund të bëhet përmes rregullave të pezullimit dhe revokimit të përcaktuara në LSSL
- Pagesat dhe taksat administrative si rregull të mos zbatohen por edhe kur parashikohen të mos kalojnë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e organit publik për të administruar lejimin;
- Të përditësohet Regjistri për të përfshirë lejimet që mungojnë, përkatësisht Licencën për veprimtaritë botuese, Vendimin për njohjen e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor, Licencën profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore dhe Licencën profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore.
- Në përgjithësi ka kërkesa për aplikim të cilat janë të panevojshme por edhe të papërshtatshme të sigurohen p.sh. kopje të noterizuara të dokumentacionit.

4.2. Rekomandimet e veçanta

Pjesë e këtij raporti është edhe analiza që identifikon secilin lejim të analizuar, emrin dhe llojin e lejimit, autoritetin përgjegjës, të gjeturat, si dhe rekomandimet e veçanta për thjeshtim. Kjo analizë është paraqitur në Shtojcën I në vijim.

Shtojca 1 – Rekomandimet e veçanta

Institucioni	Nr.ref	Emri lejimit	Lloji lejimit	Autoriteti përgjegjës	Të gjeturat	Rekomandimet
MKRS	MKRS-1	Licencimi i federatave sportive	Licencë	Komisioni vlerësues për licencim të Federatave sportive, MKRS. Vendimin e nënshkruan Ministri për dhënie apo refuzim, në bazë të rekomandimit të Komisionit	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimin si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Afati përfundimtar për vendimin lidhur me licencimin apo refuzimin e licencës është 60 ditë që është në kundërshtim me nenin 98 të LPPA.</p> <p>3. Nuk është e qartë nëse në disa prej kërkesave për dokumentacion kërkohet dokument origjinal apo vetëm kopje.</p> <p>4. Vlefshmëria e licencës është deri në 5 vite.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive, përkatësisht në titullin e U.A. dhe dispozitat përkatëse ku përmendet “licencimi” të zëvendësohet me “leje.”</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive, neni 27 paragrafi 3 për të harmonizuar afatin përfundimtar për vendimin lidhur me licencimin apo refuzimin e licencës prej 60 ditë në 45 ditë, sipas nenit 98 të LPPA.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 01/2022 për kushtet, kriteret dhe procedurat e themelimit, licencimit dhe ri-vlerësimit të federatave dhe organizatave sportive, neni 12 dhe shtojca e U.A. për të përcaktuar se kërkohen vetëm kopje të</p>

						certifikatës së regjistrimit në Departamentin përkatës për OJQ-të dhe certifikatës së numrit fiskal.
MKRS	MKRS -2	Leje per administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta	Leje	Zyra për të Drejtat e Autorit, MKRS	<p>1. Afati për nxjerrjen e vendimit për kërkesen për leje është 3 muaj që është në kundërshtim me nenin 98 të LPPA.</p> <p>2. Për kërkesat e dokumentacionit, në mes tjerash kërkohen edhe kontratë qiraje dhe certifikatë e OJQ-së.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatesisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta, neni 4 për të harmonizuar afatin për vendimin lidhur me kërkesen për leje prej 3 muaj në 45 ditë, sipas nenit 98 të LPPA.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotësohet Rregullores Nr. 01/2012 për procedurat e dhënies, përkatesisht marrjes së lejes, shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të përbashkëta, neni 21 për të përcaktuar se kërkohen vetëm kopje të kontratës së qirasë dhe certifikatës së OJQ-së.</p>
MKRS	MKRS-3	Licencë për veprimtaritë botuese	Licencë	Departamenti i Kulturës, MKRS Lëshohet me vendim nga Ministri.	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimi si licencim nuk është adekuat.</p> <p>2. Afati për shqyrtimin e kërkesës për këtë licencë është 60 ditë që është në kundërshtim me nenin 98 të LPPA.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 02/L-51 për Veprimtarinë Botuese dhe Librin, neni 16 nënparagrafi 19.2 për të përcaktuar se për personat juridik lëshohet leje dhe Rregullorja Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë, përkatësisht dispozitat ku permendet “licenca” për persona juridik të zëvendësohet me “leje.”</p>

					<p>3. Nuk është e qartë nëse kërkesa për certifikatë të regjistrimit si biznes kërkohet si dokument origjinal apo vetëm kopje.</p> <p>4. Vlefshmëria e licencës është deri në 5 vite.</p>	<p>2. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë, neni 7 paragrafi 4 për të harmonizuar afatin për vendimin lidhur me kërkesen për licencë prej 60 ditë në 45 ditë, sipas nenit 98 të LPPA.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë, neni 19 për të përcaktuar se kërkohet vetëm kopje e certifikates së regjistrimit si biznes.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotësohet Rregullorja Nr. 03/2009 për licencimin dhe regjistrimin e shtëpive botuese në Kosovë, neni 9 që të mundësohet dhënia e licencës në afat prej 7 vitesh.</p>
MKRS	MKRS-4	Vendim për njohjen e Këshillit Qëndror të Veprimit Rinor (KQVR)	Regjistrim	Departament i Rinisë, MKRS	<p>1. Nuk ka bazë të qartë ligjore për këtë lejim. Si rrjedhojë, përcaktimi i këtij lejimi nuk është në pajtueshmëri me LSSL.</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, neni 8, për të përfshirë këtë lejim sipas kriterit të LSSL për përcaktim të lejimeve vetëm me ligj.</p>

MKRS	MKRS -5	Licencë profesionale për persona fizik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e trashëgimisë kulturore	Licencë	Departamenti i Kulturës, MKRS	<p>1.Për këtë lejm, tarifat e aplikimit janë si në vijim:</p> <p>1.1. Licenca A1 dhe A4 - 100 euro,</p> <p>1.2. Licenca A2 dhe A3 - 70 euro,</p> <p>1.3. Licenca A5 - 70 ose 100 euro, varesisht nga nënkategoria,</p> <p>Per rilicencim paguhet 50 % e tarifës fillestare. Këto tarifa nuk duket që janë llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejm.</p> <p>2. Afati i vlefshmërisë së kësaj licence është 5 vite.</p>	<p>1.Të ndryshohet/plotesohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik në fushën e trashëgimisë kulturore, neni 32 për të përcaktuar tarifat në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejm.</p> <p>2. Të ndryshohet/plotesohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik në fushën e trashëgimisë kulturore, neni 18 nëparagrafi 1.1, që të mundësohet dhënia e licencës me afat të vlefshmërisë prej 7 vitesh.</p>
MKRS	MKRS-6	Licencë profesionale për persona juridik për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e		Departamenti i Kulturës, MKRS	<p>1. Sipas LSSL licenca ipet për personat fizik dhe jo për personat juridik dhe në këtë rast emërtimi si licencë nuk është adekuat.</p> <p>2.Për këtë lejm, tarifat e aplikimit janë si në vijim:</p>	<p>1. Të ndryshohet/plotësohet Ligji Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, përkatësisht në dispozitat përkatëse ku përmendet licencimi për persona juridik të zëvendësohet me “leje për persona juridik”, dhe Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik në</p>

		trashëgimi së kulturore			<p>1.1. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B1 - 500 euro;</p> <p>1.2. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B2 - 700 euro;</p> <p>1.3. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B3 - 1,000 euro;</p> <p>1.4. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B4 - 1,000 euro;</p> <p>1.5. Licencë profesionale për persona juridikë Licencë B5 - 3,000 euro;</p> <p>Për rilicencimin e personave fizikë dhe juridikë paguhet 50% e shumës së përcaktuar në këtë udhëzim administrativ. Këto tarifa nuk duket që janë llogaritur në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>3. Afati i vleshfshmërisë së kësaj licence është 5 vite.</p>	<p>fushën e trashëgimisë kulturore, përkatesisht në titulin e U.A. dhe dispozitat përkatëse ku permendet “licenca profesionale për persona juridik” të zëvendësohet me “leje per persona juridik.”</p> <p>2. Të ndryshohet/plotesohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 per kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik ne fushën e trashëgimisë kulturore, neni 32 për të përcaktuar tarifat në bazë të shpenzimit të procedurës administrative të organit kompetent për të administruar këtë lejim.</p> <p>3. Të ndryshohet/plotesohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 per kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për persona fizik dhe juridik ne fushën e trashëgimisë kulturore, neni 18 nënparagrafi 1.2, që të mundësohet dhënia e licencës me afat 7 vjeçar.</p> <p>4. Të ndryshohet/plotesohet Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr.03/2021 per kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e</p>
--	--	-------------------------	--	--	---	---

				<p>4. Dokumentacioni i kërkuar për këtë aplikim, në mes tjerash përfshinë kopjet e noterizuara të licencave të stafit profesional në bazë të të cilit personi juridik kërkon të licenohet, kopjet e noterizuara të kontratave të punës me afat të pacaktuar ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe stafit profesional të licencuar në bazë të të cilit kërkon të licenohet, certifikatën e regjistrimit si person juridik pranë institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës, dhe certifikatën e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Kërkesat për noterizim paraqesin barrë shtesë administrative për palët që aplikojnë.</p>	<p>licencave profesionale për persona fizik dhe juridik ne fushën e trashëgimisë kulturore, neni 15 për të përcaktuar se kërkohet vetëm kopjet e licencave të stafit profesional në bazë të të cilit personi juridik kërkon të licenohet, kopjet e kontratave të punës me afat të pacaktuar ndërmjet përfaqësuesit ligjor të personit juridik dhe stafit profesional të licencuar në bazë të të cilit kërkon të licenohet, kopjen e certifikatës së regjistrimit si person juridik pranë institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës, dhe kopjen e certifikatës e lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p>
--	--	--	--	---	---